



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:017093
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05513391

2024:017093

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Blerina KURTAJ, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit SH.A., nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1,562.88 Euro, jashtë seance me datë 27 mars 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit SH.A., nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të lartcekur në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 24 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 01.02.2021 deri me datë 06.02.2023, të ia paguajë shumën prej 1.562.88-€ (njëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy euro, e tetëdhjetë e tetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 26.12.2023 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124.00.-€ (njëqind e njëzetë e katër euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi SH.A., nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 26.12.2023, përmes të autorizuarit të tij Fitim Gashi, avokat në Prishtinë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në Institucionin Arsimor “...” në fshatin..., Komuna Gjakovë. I njëjti ka diplomuar në Fakultetin e Edukimit, në Universitetin e Prishtinës, me datë 16.09.2014 dhe është i licencuar me Licencë të Karrierës, ndërsa me padi ka kërkuar që në emër të kualifikimit nga data 01.02.2021 deri me datë 06.02.2023, të i paguhet shuma në lartësi prej 1.562.88-€, po ashtu ka kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 02.02.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditëses nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësi dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Po ashtu, paditëses nuk i takon ky kompensim as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parasheh që punëtorëve të arsimit iu takon kompensimi i tillë, prandaj kërkesës së paditëses i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësi nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin Sh.A., e lëshuar nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria

Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësi i lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në Institucionin Arsimor “..” në fshatin Komuna Gjakovë, si mësimdhënës i lëndës Biologji-Kimi. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën 01.06.2021-30.06.2021, 01.11.2022-30.11.2022 vërtetohet fakti se paditësi realizon pagë bazë në lartësi prej 495.30 (koeficient 7.8) Euro, meqenëse i njëjti ka diplomuar me datë 16.09.2014 dhe ka marrë titullin Bachelor i Biologjisë- Kimisë, fakt që vërtetohet përmes Diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, me numër 794. Po ashtu paditësi ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 100008716. Gjykata konform nenit 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, provave të lartcekura iu falë besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023 ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa pika 4 nën-pika 3 e tij, ka përcaktuar se *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%”*. Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, se e njëjta ka diplomë universitare me titull Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë dhe ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 01.02.2021 deri me datë 06.02.2023 apo për 25 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumën prej 1,562.88 euro, për këtë kriter të kompensimit.

Duke qenë se kjo gjendje faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësi është e punësuar tek e paditura dhe se në periudhën prej datës 01.02.2021 deri me datë 06.02.2023 të njëjtës për 8 muaj nuk i është

kompensuar pjesa tjetër e shtesave në emër të kualifikimit, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për kualifikim, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiisë rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, ky pretendim rezulton i pabazuar sa i përket periudhës prej datës 01.02.2021 deri me datë 06.02.2023 pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 26.12.2023, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me mungesën e buxhetit, edhe ky pretendim është i pabazuar dhe nuk gjen mbështetje në asnjë normë ligjore të aplikueshme, e për më tepër gjykata e vlerëson si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, pasi që paditësi nuk është përgjegjës për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga Vendimi numër 01/33, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës lidhur me mos planifikimin me kohë të buxhetit për zbatimin e vendimit të lartcekur nuk e liron të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 par. 2 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç’rast paditëses iu

pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (të parapara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

2024:017093, datë 27 mars 2024

Gj y q t a r j a,
Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.